

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)

Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash 34330000-9

Filtra vaji 42913300-2, Graso dhe lubrifikantë 24951000-5

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 6,141,636 (gjashtë milion e njëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme."

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo**

më pak se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë / broshurë / skedë teknike** për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit. (Nëse katalogu/ broshura/skeda teknike paraqitet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve /broshurës/ skedës teknike është një kërkesë proporcionale dhe ngushtësisht e lidhur me objektin e prokurimit pasi i jep mundësinë Organit Qendror Blerës për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues për llogari të të cilit Organi Qendror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”/ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një **deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike të posaçme për artikujt e kërkuar nga autoriteti kontraktor përfitues:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
A	Emertimi I filtrave te eskavatoreve Fiat Hitachi Ex-255. Nr.shasie 225ML0204 I vitit 2000 CUMMINS 6CT8.3		
1	Filtra ajri(jashtem+brendshem)	kit	12
2	Filtra hidraulikut(kartonit)	cope	12
3	Filtra vaj motorri	cope	24
4	Filtra nafte te trashe	cope	24
5	Filtra nafte te imet	cope	24
6	Parafilter nafte	cope	3
7	Filtra uji	cope	4
B.	Emertimi I filtrave te eskavatoreve XCMG 260 CLL. Nr.shasie XUGO2603HGKA01628 ISUZU CC-6BG1 TRP-08		
1	Filtra ajri(jashtem+brendshem)	kit	9
2	Filtra hidraulikut(kartonit)	cope	9

3	Filtra vaj motorri	cope	18
4	Filtra nafte te trashe	cope	18
5	Filtra nafte te imet	cope	18
6	Filtra uji	cope	3
C	Emertimi I filtrave te eskavatorit HIDROMEK . HMK 230 LC SLR-3A ISUZU ,MODEL 4HK1X		
1	Filtra ajri(jashtem+brendshem)	kit	3
2	Filtra hidraulikut(kartonit)	cope	3
3	Filtra vaj motorri	cope	3
4	Filtra nafte	cope	9
5	Filtra hidraulikut(metalik)	cope	2
D	Emertimi I filtrave kamion. IVEKO 190-38T VITI I PRODH. 1980 Nr.shasie ZCFM1VRH004045921		
1	Filtra ajrit (jashtem e brendshem)	kit	1
2	Filtrer uji	cope	1
3	Filtra vaj motorrit	cope	3
4	Filtra nafte	cope	1
5	Parafilter nafte	cope	1
E	Emertimi I filtrave kamion. IVEKO 19-30 VITI I PRODH. 1991 Nr.shasie ZCFA1VMS001137938		
1	Filtra ajrit (jashtem e brendshem)	kit	1
2	Filtrer uji	cope	1
3	Filtra vaj motorrit	cope	2
4	Filtra nafte	cope	1
5	Parafilter nafte	cope	1

F	FORD EVEREST 2.5 Viti I prodhimit 2011 Nr.shasie MNCLS4D10BW317637		
1	Filtra ajrit	cope	3
2	Filter kondicioneri	cope	3
3	Filtra vaj motorri	cope	3
4	Filtra nafte	cope	3
5	Parafilter nafte	cope	3
G	FORD RANGER 2.2 Viti I prodhimit 2014 Nr.shasie 6FPPXXMJ2PEB17817		
1	Filtra ajrit	cope	3
2	Filter kondicioneri	cope	3
3	Filtra vaj motorri	cope	3
4	Filtra nafte	cope	3
5	Parafilter nafte	cope	3
H	IVEKO FIAT DAILY 35.8 Nr.shasie ZCFC3550102076780 ME MOTORRSALDATRICE		
1	Filtra ajrit	cope	1
2	Filtra vaj motorri	cope	1
3	Filtra nafte	cope	1
4	Parafilter nafte	cope	1
I	LAND ROVER DEFENDER VITI I PRODHIMIT 2002 NR.SHASIE SALLDHMF82A646680		
1	Filtra ajrit	cope	3
2	Filtra vaj motorri	cope	3
3	Filtra nafte	cope	3

4	Parafilter nafte	cope	3
J	Emertimi I lubrifikanteve per Makinerine e Rende dhe Hidrovore "BLERJE PJESESH KEMBIMI PER AUTOMJETE,PER SHERBIMET PROFILAKTIKE 2024		
46 Vaj hidraulik HLP 68	Vaj hidraulik HLP 68	litra	1800
17	Vaj motori automjete 20W-50	litra	300
16	Vaj motorri marinë 15W40	litra	350
7	Vaj motori automjete 5W-30	litra	21
9	Vaj motori automjete 5W-40	litra	21
12	Vaj motori automjete 10W-40	litra	22
33	Vaj për kuti shpejtësie 80W-90	litra	200
19	Vaj motori automjete SAE 30	litra	400
57	Antifrizë motori (- 40°C)	litra	140
59	Graso litium EP-2	KG	2100
60	Graso litium EP-3	KG	2100

GRASO SOLIDOL

Penetrimi ne kon 280⁰
 NLGI 2
 Pika e pikimit ⁰C 95
 Shkalla e temp. -20⁰ deri 65⁰C

ISO 6743-9 L-XBAHA2/L-XBAHA3 DIN 51502.

Ambalazhimi duhet te jete 4-16 kg(1/2 e sasise).

Keto specifikimi te Graso Solidol duhet te jene ne etiketen e mallit.

Viti i prodhimit 2024-2025.

GRASO KOSTALINE

Penetrimi ne kon 25 ⁰ C	280
NLGI	2
Pika e pikimit ⁰ C	200
Shkalla e temp ⁰ C	-20 deri 120 grade celsius
ISO 6743-9	L-XCCHA2 DIN51502 K2K-30

Keto specifikime te Graso Kostaline duhet te jene ne etiketen e ambalazhit.

Viti i prodhimit te jete viti 2024-2025.

Ambalazhimi duhet te jete 4-16 kg(1/2 e sasise).

V.O : Certifikate origjine dhe analiza laboratorit te vajit

15W-40

Klasifikimi	15W-40
Viskozitetit ,cSt@100 ⁰ C	14-15.5
Viskozitetit ,cSt@40 ⁰ C	95-120
Densitetit ,kgr/l ^t 15 ⁰ C	0.86-0.88
Pika e rrjedhjes , ⁰ C(max)	-25
Pika e flakerimit . COC , ⁰ C (min)	230

Indeksi I viskozitetit min	140
Permbajtja e hirit max	1%
Permbajtja e ujit max	0.05
Ambalazhimi duhet te jete 5-10 lt.	

V.O : Certificate origjine dhe analiza laboratorit te vajit

20W-50

Klasifikimi	20W-50
Densiteti ,kgr /lt@15 ⁰ C	0,86-0.88
Viskoziteti ,cSt@100 ⁰ C	19.5-21.5
Viskoziteti ,cSt@40 ⁰ C	150-180
T.B.N (mgKOH/gr)	8-10
Pika e rrjedhjes , ⁰ C(max)	-20
temperatura e flakerimit . COC , ⁰ C (min)	230
Indeksi I viskozitetit min	140
Permbajtja e hirit max	1%
Permbajtja e ujit max	0.05
Ambalazhimi duhet te jete 5-10 lt	

V.O : Certificate origjine dhe analiza laboratorit te vajit

5W-30

Klasifikimi	5W-30
Densiteti ,kgr /lt@15 ⁰ C	0,85-0.87
Viskozitetiti ,cSt@100 ⁰ C	9.3-12.5
Viskozitetit ,cSt@40 ⁰ C	55-65
T.B.N (mgKOH/gr)	8-10
Pika e rrjedhjes , ⁰ C(max)	-30
temperatura e flakerimit . COC , ⁰ C (min)	200
Indeksi I viskozitetit min	160

Permbajtja e hirit max	1%
Permbajtja e ujit max	0.05

V.O : Certificate origjine dhe analiza laboratorit te vajit

5W-40

Klasifikimi	5W-40
Densiteti ,kgr /lt@15 ⁰ C	0,85-0.87
Viskozitetiti ,cSt@100 ⁰ C	12.5-16.3
Viskozitetit ,cSt@40 ⁰ C	75-100
T.B.N (mgKOH/gr)	8-10
Pika e rrjedhjes , ⁰ C(max)	-30
temperatura e flakerimit . COC , ⁰ C (min)	220
Indeksi I viskozitetit min	160
Permbajtja e hirit max	1%
Permbajtja e ujit max	0.05

V.O : Certificate origjine dhe analiza laboratorj te vajit

10W-40

Klasifikimi	10W-40
Densiteti ,kgr /lt@15 ⁰ C	0,85-0.88
Viskozitetiti ,cSt@100 ⁰ C	13.5-15.0
Viskozitetit ,cSt@40 ⁰ C	90-120
T.B.N (mgKOH/gr)	8-10
Pika e rrjedhjes , ⁰ C(max)	-25
temperatura e flakerimit . COC , ⁰ C (min)	220

Indeksi I viskozitetit min	140
Permbajtja e hirit max	1%
Permbajtja e ujit max	0.05

V.O : Certificate origjine dhe analiza laboratorj te vajit

80W-90

Klasifikimi	10W-40
Densiteti ,kgr /lt@15 ⁰ C	0,86-0.90
Viskozitetiti ,cSt@100 ⁰ C	14.5-16.5
Viskozitetit ,cSt@40 ⁰ C	135-165
T.B.N (mgKOH/gr)	8-10

Pika e rrjedhjes , °C(max)	-15
temperatura e flakerimit . COC , °C (min)	230
Indeksi I viskozitetit min	130
Permbajtja e hirit max	1%
Permbajtja e ujit max	0.05
V.O : Certifikate origjine dhe analiza laboratorit te vajit	

SAE 30

Klasifikimi	SAE 30
Densiteti ,kgr /lt@15°C	0,87-0.89
Viskoziteti ,cSt@100°C	10.0-12.0
Viskoziteti ,cSt@40°C	85-100
T.B.N (mgKOH/gr)	8-10

Pika e rrjedhjes , °C(max)	-26
temperatura e flakerimit . COC , °C (min)	210
Indeksi I viskozitetit min	90
Permbajtja e hirit max	1%
Permbajtja e ujit max	0.05
Ambalazhimi	10 lt.

Niveli ISO i Viskozitetit **cis 46**

Densiteti ne 15° ,gr/cm ³	0,85-0.87
Viskozitetiti ,cSt@100 ⁰ C	6.5-7.5
Viskozitetit ,cSt@40 ⁰ C	42-50
T.B.N (mgKOH/gr)	8-10
Pika e rrjedhjes , °C	-20
temperatura e flakerimit . COC , °C	min 200
Indeksi I viskozitetit	min100
Permbajtja e hirit max	1%
Permbajtja e ujit	max 0.05%
Ambalazhimi duhet te jete 10-20 lt	

Antifrize

Densiteti ,kgr/lt @ 20°C	1,12
Pika e vlimit, °C	174
Pika e ndezjes . COC , °C	125
Kunder ngrirjes pH 33%	8.4
Mbrojtje,kunder ngrirjes 50%, °C	-35
Ambalazhi duhet të jete 1 lt	

Për çdo standard të kërkuar apo çdo referencë marke e mundshme në mallrat objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij / saj.

Argumentimi: *Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktor përfitues për objektin që prokurohet sipas nevojës, duke përcaktuar informacionin minimal të nevojshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke u referuar*

për disa artikuj edhe në katalogun e unifikuar nga organi qendror blerës për pjesët e këmbimit për automjete, për shërbimet profilaktike, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Specifikimet teknike të përcaktuara në këto dokumente tenderi i përgjigjen nevojës së autoritetit kontraktor përfitues, çka nënkupton plotësimin e nevojave me cilësinë e kërkuar dhe pa vonesë. Certifikatat e origjinës dhe analizat laborator të vajit /grasos, të kërkuara nga autoriteti kontraktor përfitues Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë janë vlerësuar të nevojshme për fazën e zbatimit të kontratës pranë këtij AK përfitues, me qëllim verifikimin nga ky i fundit respektimin në vazhdimësi të specifikimeve teknike gjatë zbatimit të kontratës.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT: